



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2020:149603

Datë: 07.04.2021

Numri i dokumentit: 01668509

**P.nr.781/20**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti i përgjithshëm**, gjyqtari Shaqë Curri, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Fitore Bojku, në çështjen penale ndaj të pandehurit F. E. nga ..... për shkak të veprës penale heqje apo dëmtim i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 406 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë Departamenti për krime të përgjithshme, PP/II.nr.1810/20 të dt. 29.10.2020 duke vendosur në lidhje me kërkesën për dhënien e urdhrit ndëshkimorë, konform nenit 495 par 1 të KPP-së jashtë seance me datë 12.03.2021 merr këtë:

**A K T G J Y K I M**

**PRANOHET** kërkesa Prokurorisë Themelore në Pejë, Departamenti për krime të përgjithshme, PP/II.nr.1810/20 të datës.29.10.2020, dhe kjo gjykatë, pa mbajtur shqyrtim gjyqësor jep **URDHËR NDËSHKIMOR**.

**I pandehuri F. E.**, i lindur me datë ..... në fsh. ...., K. .... me banim përball Stacionit Policor në ....., i biri i M. dhe nënës H., i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr. ...., posedon telefon me numër ....., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

**ËSHTË FAJTOR**

Për shkak se:

Me datë 02.03.2020, rreth orës 11:50, në fsh. ...., K-....., duke hequr vulën zyrtare të ngjitur nga zyrtari i autorizuar me qëllim të sigurimit të objektit, në atë mënyrë që pasi që, i pandehuri ishte duke ndërtuar tri shtëpi njëkohësisht pa leje ndërtimi në vendin e lartcekur, me parë me dt. 26.02.2020 i janë vendosur shiritit-vulat zyrtare me qëllim që ti ndërpresë punimet deri në pajisjen me leje ndërtimi, mirëpo i njëjti ka hequr vulat zyrtare ku me dt. 02.03.2020 hetohen nga inspektorët komunal dhe Policia e Kosovës.

-me çka ka kryer veprë penale heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 406 të KPRK-së.

Andaj, Gjykata konform nenit 7,21, 43 nenit 406 të KPRK-së, nenit, 365 dhe 495 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, të pandehurit i shqipton:

## **DËNIM ME GJOBË**

**Dënim me gjobë në shumë prej 500 (pesëqind) Euro**, të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 30(tridhjetë) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri i lartcekur dënimin nuk e paguan në afat të caktuar, atëherë dënimi me gjobë gjykata do ta zëvendësoi me dënim burgu, duke llogaritur një ditë burgim për çdo 20 euro të gjobës.

I pandehuri obligohet që në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej 20 (njëzet) euro në afat prej 30 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I pandehuri obligohet që të paguajë taksën për programin e kompensimit të viktimave të krimit, në shumë prej 30 (tridhjetë) euro, në afat prej 30 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Pejë, Departamenti për krime të përgjithshme, ndaj të pandehurit F. E. nga ..... , ka ngrit aktakuzë PP/II.nr.1810/20 të datës. 29.10.2020, për veprën penale heqja apo dëmtim i vulave zyrtare , nga neni 406 të KPRK-së .

Konform nenit 493 të KPP të Kosovës, Prokuroria Themelore në Pejë, pas ngritjes së aktakuzës ka kërkuar që gjykata pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësorë, të lëshoi urdhër ndëshkimorë me të cilin të pandehurit t'ia shqiptoi dënim me gjobë.

Gjykata me rastin e shqyrtimit të çështjes konform nenit 495 të KP të Kosovës, gjeti se janë plotësuar kushtet nga dispozita e nenit 493 të KPP të Kosovës dhe pa mbajtur shqyrtimin gjyqësorë vendosi që ta pranoi kërkesën e Prokurorisë Themelore në Pejë, Departamenti për krime të përgjithshme për dhënien e urdhrin ndëshkimorë dhe shqiptoi ndaj të pandehuri dënimin me gjobë si në dispozitiv të aktgjykimit.

Kjo gjykatë konsideron se provat e bashkangjitura shkresave të lëndës: shënimi zyrtar i oficerit I. F. #7237 i dt. 02.03.2020, intervista e të dyshuarit e dhënë në Stacionin Policor në Pejë më dt. 02.03.2020, procesverbal mbi kryerjen e kontrollit i dt. 02.03.2020 nr. 18-354 i Divizionit për inspektimin e Ndërtimeve të Komunës së Pejës, fotografitë e vendit të ngjarjes, si dhe shkresat tjera të lëndës, janë prova të besueshme mbi bazën e të cilave vërtetohet se i pandehuri është kryes i veprës penale për të cilën është akuzuar.

Andaj, gjykata të pandehurin e dënoi si në dispozitiv të aktgjykimit duke qenë i bindur se ky dënim është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë së veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale, se me këtë dënim ndaj tij mund të arrihet qëllimi i dënimit të cilën e parasheh dispozita e nenit 38 të KP të Kosovës.

Vendimi lidhur me paushallin gjyqësorë u murr konform nenit 450 par.1 dhe 2 pika 2.6 të KPP të Kosovës.

Konform nenit 39 par.1, 2, 3, nënpar.3.1, të ligjit për kompensimin e viktimave të krimit, e obligoi në pagesën e taksës, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Konform nenit 463 par. 2 të KPP-së, për realizimin e kërkesës pasurore juridike i dëmtuari për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 365 dhe 495 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**NGA GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti i përgjithshëm,  
P.nr.781/20, të datës 12.03.2021.**

**SEKRETARJA JURIDIKE**  
Fitore Bojku

**GJYQTARI**  
Shaqë Curri

**UDHËZIM JURIDIK:**

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtim në afat prej 8 ditësh në këtë gjykatë, e përmes zyrës së pranimit të kësaj gjykate.